




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-0/DPK
 Nr. Prot. 01-448/14
 Br. Prot. Prot No
 Nr. lfaq. Data
 Broj stranica Datum
 Nr. pages Date 03 05.02.2014
 PRISTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	05/02/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Xhevdet RAMOSAJ Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Deçanit
CC:	z. Rasim SELMANAJ Kryetar i Komunës së Deçanit
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin "Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në territorin e Komunës së Deçanit"



I nderuari z. RAMOSAJ,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin " Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në territorin e Komunës së Deçanit ", me nr. të prokurimit: 61313070211, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin " Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në territorin e Komunës së Deçanit " në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit në Komunën e Deçanit ka përgatitë “Njoftimin për Kontratë” me titull “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në territorin e Komunës së Deçanit” me nr. prokurimi: 61313070211, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me datë:16.12.2013, në Procedurë të Hapur. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë procedurë prokurimi si rast për trajtim. Gjatë ekzaminimit të dokumentacionit të kësaj procedure të prokurimit në “Njoftimin për Kontratë”, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Në “Njoftimin për Kontratë” të publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, më datë: 16.12.2013, tek pika III.2 e rubrikës “Kapaciteti teknik dhe profesional”, pika 10 është kërkuar që bartësi kryesor i projektit të ketë mbi 60 % të vlerës së Projektit. Gjithashtu e njëjta pikë është përshkruar edhe në “Dosjen e Tenderit“, që ka përgatitur Autoriteti Kontraktues për këtë tender, pikë kjo e cila konsiderojmë se bie ndesh me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik.

Komuna e Deçanit si Autoriteti Kontraktues këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka paraparë në planifikimin e prokurimit për vitin 2013. Legjislacioni në fuqi, mundëson që aktivitet e prokurimit që nuk janë paraparë për vitin përkatës fiskal, mund të prokurohen nëse për të njëjtin prokurim Zyrtari Kryesor Administrativ do të dërgojë tek Agjencia Qendrore e Prokurimit një kopje të Deklaratës përkatëse të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve së paku 5 ditë para se Zyrtari Autorizues të autorizojë Zyrtarin e Prokurimit për iniciimin e aktivitetit përkatës të prokurimit.

Agjencia kundër Korrupsionit konstaton se Autoriteti kontraktues ka klasifikuar këtë aktivitet të prokurimit të llojit Shërbime, ndërsa është dashur që këtë aktivitet ta klasifikoj konform natyrës së punëve dhe shërbimeve. Duke u bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik gjegjësisht Neni 15 dhe interpretimin ligjor të datës: 13.01.2014 të cilin e kemi kërkuar nga KRPP-ja, lidhur me klasifikimin e kontratave të Përziera konstatohet qartë se Kontrata që përfshin njëkohësisht Punët dhe shërbimet, konsiderohet si kontratë pune nëse vlera e parashikuar e punëve e kalon vlerën e parashikuar të shërbimeve, ose anasjelltas.

Autoriteti kontraktues më datë:10.01.2014 ka bërë njoftimin për dhënie të kontratës në faqen elektronike të KRPP-së, Agjencia kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka kërkuar nga Autoriteti Kontraktues Dosjen e tenderit dhe ofertat origjinale të OE. Gjatë ekzaminimit dhe krahasimit të dokumentacioneve AKK ka konstatuar se OE i cili është shpërblyer me kontratë nuk i ka përmbushur disa nga kërkesat. Tek rubrika “Kërkesat e përshtatshmërisë”, ku është kërkuar Plani Dinamik për kryerjen e punëve sa më i detajuar, OE i cili është shpërblyer me kontratë në ofertën e tij nuk ka bashkangjitur planin dinamik të detajuar konform me “Njoftimin për kontratë” dhe “Dosjen e tenderit”. Po ashtu OE nuk ka përmbushur pikën 2 e cila është kërkuar tek rubrika “Kapaciteti teknik dhe profesional”, ku është kërkuar tek personeli kryesor teknik një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë me 2 vite përvojë pune dhe minimum 1 projekt të realizuar në lëmin e mirëmbajtjes të rrugëve, me prezantimin e CV-së, Diplomës së noterizuar nga noteri... OE nuk ka ofruar Diplomë të ndërtimtarisë, por vetëm një Certifikatë të noterizuar e cila nuk është konform Dosjes së Tenderit.



Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim/jo-Diskriminimi; nenin 15 Klasifikimi i Kontratave të përziera; nenin 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik; dhe Nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!

